

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXVI, nr. 8257  
E shtunë, 7 mars 2026  
Çmimi 0.50 €

## ShBA-ja dhe Izraeli zotohen se nuk do të ndalen kundër Iranit

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# PRESIDENTJA SHPËRNDAN KUVENDIN, LV-ja E ÇON DEKRETIN NË KUSHTETUESE



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka nxjerr të premten dekret për shpërndarjen e legjislativës së dhjetë të Kuvendit, pasi ky institucion dështoi ta zgjidhte presidentin e ri deri më 5 mars. Ndërkaq Lëvizja Vetëvendosje vendimin e presidentes e ka dërguar në Kushtetuese. Seanca e 5 marsit dështoi në mungesë kuorumi, meqë në sallë nuk ishin deputetët e partive opozitare. Kryetarja e Kuvendit,

Albulena Haxhiu kërkoi menjëherë nga Gjykata Kushtetuese që të pezullohen afatet kushtetuese në mënyrë që presidenti të zgjidhet brenda 60 ditësh. Kryeministri Kurti gjatë një konference për medie, e ka kundërshtuar shpërndarjen e Kuvendit, duke theksuar se s'mund të flitet për zgjedhje të reja, meqë duhet të flasë Gjykata Kushtetuese për lëndët që janë deponuar

## AKTUALE



**BASHKIMI EVROPIAN KUFIZON  
NDIHMAT PËR TË HUAJT** F. 2

**ARTA GASHI - AHMETAJ SHPALLET  
MËSUESJA MË E MIRË E VITIT** F. 6

**KGJK-JA I PROPOZON  
PRESIDENTES 28 GJYQTARË  
PËR RIEMËRIM ME MANDAT  
TË PËRHERSHËM** F. 7


## EKONOMI



**DHOMA E TREGTISË  
KUNDËRSHTON FAZËN E DYTË  
TË LIBERALIZIMIT TË TREGUT  
TË ENERGJISË** F. 8

**RRITEN ÇMIMET E PRONAVE TË  
BANIMIT** F. 8

## SPORT



**BROJA MUND T'I THOTË  
"MIRUPAFSHIM" KOMBËTARES  
SHQIPTARE** F. 11



**PREKAZI,  
SIMBOL  
I SAKRIFICËS,  
UNITETIT DHE  
VENDOSMËRISË  
PËR LIRI** F. 4-5

**FSK-ja DREJT  
PËRFSHIRJES  
NË MISION  
NDËRKOMBËTAR NË  
GAZA, ZHVILLOHET  
TAKIM KOORDINUES  
ME KOMANDËN  
AMERIKANE** F. 6



**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
030 500 878 | 045 500 870  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# TRUMPI U BËN THIRRJE FORCAVE IRANIANE T'I ULIN ARMËT

WASHINGTON, 6 MARS - Presidenti amerikan Donald Trump u ka bërë thirrje anëtarëve të ushtrisë dhe policisë iraniane si dhe Gardës Revolucionare Islamike të Iranit që t'i ulin poshtë armët, duke u premtuar "imunitet të plotë" nëse e braktisin udhëheqjen klerikale të shtetit.

Ai i ka bërë këto deklarata teksa shqetësimet sa shkojnë e rriten që lufta e Shteteve të Bashkuara dhe Izraelit ndaj Iranit po përhapet në gjithë Lindjen e Mesme dhe nuk po prek vetëm aleatët arabë të Uashingtonit, por edhe vendet e tjera që nuk janë pjesë e Gjirit, sikurse Azerbajxhani, Turqia, Qiproja dhe madje Shri Lanka, rreth 3 900 kilometra larg.

Trumpi, duke folur nga Shtëpia e Bardhë më 5 mars, u ka bërë thirrje forcave të sigurisë që të rreshtohen me popullin iranian dhe të ndihmojnë në rrëzimin e qeverisë që e ka udhëhequr shtetin prej Revolucionit Islamik të vitit 1989. "U bëj thirrje edhe një herë të gjithë anëtarëve të Gardës Revolucionare Islamike, ushtrisë dhe policisë, që t'i ulin armët. Tani është koha të rreshtoheni me popullin iranian dhe të ndihmoni në kthimin e shtetit tuaj", ka thënë Trump.

Ai u bëri thirrje edhe diplomatëve iranianë që janë nëpër vende të ndryshme, që të kërkojnë azil dhe të ndihmojnë në formësimin e së ardhmes së Iranit. "U bëjmë thirrje diplomatëve iranianë nëpër botë që të kërkojnë azil dhe të ndihmojnë në krijimin e një Irani të ri dhe më të mirë, me potencial të madh".

Më vonë, në një intervistë për transmetuesin NBC News,



Trump ka thënë se nuk po e shqyrton angazhimin e trupave amerikane tokësore në Iran. "Është humbje kohe. Ata kanë humbur gjithçka. E kanë humbur marinën. Kanë humbur gjithçka që mund të humbnin", ka thënë ai për "NBC News" në një thirrje telefonike, duke shtuar se komenti i ministrit të Jashtëm iranian, Abbas Araçchi, se Irani është gati nëse do të ketë ndonjë pushtim tokësor, është "koment shterpë".

## Pretendimet për humbje të mëdha ushtarake

Presidenti amerikan ka pretenduar se kapacitetet e ushtrisë iraniane janë degraduar rëndë pas luftimeve të fundit. "Në vetëm tre ditë, armët anti-ajrore janë

zhdukur. Nuk kanë forcë ajrore. Nuk kanë mbrojtje ajrore", ka thënë Trump. "Të gjithë aeroplanët e tyre janë shkatërruar. Komunikimet e tyre janë shkatërruar". Sipas tij, 60 për qind e raketave iraniane dhe 64 për qind e lansuesve të raketave janë shkatërruar dhe që marina e Iranit i ka humbur 24 anije. Ai e ka akuzuar Teheranin për sulme kundër disa vendeve të Gjirit, përfshirë Katarin, Arabinë Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe. "Ata po e sulmonin gjithë Lindjen e Mesme. Më pas ne u angazhuam dhe e prishëm festën e tyre", ka thënë presidenti amerikan.

## Diskutimet për liderin e ri

Disa orë më parë Trumpi ka thënë se Uashingtoni do të

ndihmojë në zgjedhjen e liderit të ri në Iran, pasi lideri suprem, Ali Khamenei, është vrarë në fazat fillestare të luftës që ka nisur më 28 shkurt. Trumpi, duke folur për agjencinë e lajmeve "Reuters", e ka hedhur poshtë mundësinë që Mojtaba Khamenei, djali i liderit suprem të vrarë, të dalë në krye të shtetit, duke e quajtur "peshë të lehtë". "Ne duam të përfshihemi në procesin e zgjedhjes së personit që do ta udhëheqë Iranin në të ardhmen" është cituar të ketë thënë ai sipas agjencisë. "Nuk mund të shkojmë çdo pesë vjet dhe ta bëjmë këtë gjë sërish... duhet të jetë dikush që është i mirë për popullin, i mirë për shtetin. Djali i Khameneit është i papranueshëm për mua. Ne duam një figurë që do të sjellë

harmoni dhe paqe në Iran", ka thënë Trumpi në një intervistë për "Axios".

## Hegseth: Lufta sapo ka nisur

Ndërkohë sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth, e ka paralajmëruar Teheranin se ka gabuar nëse ka menduar që Shtetet e Bashkuara nuk mund ta vazhdojnë luftën, duke shtuar se forcat amerikane sapo kanë nisur të luftojnë.

Pentagoni ka thënë më 5 mars se ushtria amerikane i ka fundosur më shumë se 30 anije iraniane dhe që sulmet me raketa balistike nga Irani kanë rënë për 90 për qind prej ditës së parë të luftës. Sipas tij, rreth 60 për qind e lansuesve të raketave janë shkatërruar.

# BASHKIMI EVROPIAN KUFIZON NDIHMAT PËR TË HUAJT



BRUKSEL, 6 MARS - Gjykata Evropiane e Drejtësisë vendosi se shtetet e BE-së mund të kërkojnë që të huajt nga vendet jashtë Bashkimit Evropian të kenë leje afatgjatë qëndrimi në mënyrë që të përfitojnë ndihma sociale të cilat nuk lidhen me punësimin.

Ky vendim vlen veçanërisht për përfitimet sociale të financuara nga fondet shtetërore, si shtesa për pensionistët me të ardhura të ulëta dhe jo për ndihmat e lidhura me kontributet e punës.

Vendimi u mor pas padisë së një gruaje shqiptare që jetonte ligjërisht në Itali për dhjetë vjet me djalin e saj, thotë DW. Ajo kishte leje qëndrimi dyvjeçare dhe leje pune, por nuk kishte punuar kurrë. Kur aplikoi për shtesën e pensionit bazë, kërkesa u refuzua sepse nuk kishte leje qëndrimi afatgjatë. Gjykata Kushtetuese italiane ia referoi çështjen Gjykatës Evropiane, e cila interpretoi ligjet e BE-së mbi trajtimin e barabartë në sigurimet shoqërore.

Gjykata shpjegoi se shtesat e tilla janë ndihmë sociale e pavarur nga kontributet dhe financohen nga fondet shtetërore për t'i mbrojtur individët nga vështirësitë ekonomike. Prandaj, shtetet mund të vendosin kushte që tregojnë një nivel të caktuar integriteti si, për shembull, leja e qëndrimit afatgjatë.

Edhe qytetarët e BE-së mund të kërkojnë ndihma sociale vetëm nëse kanë të drejtë të qëndrojnë përgjithmonë në vendin përkatës.

# PRESIDENTJA SHPËRNDAN KUVENDIN, LV-ja E ÇON DEKRETIN NË KUSHTETUESE

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka nxjerrë të premtën dekret për shpërndarjen e legjislaturës së dhjetë të Kuvendit, pasi ky institucion dështoi ta zgjidhë presidentin e ri deri më 5 mars. E Lëvizja Vetëvendosje vendimin e presidentes e ka dërguar në Kushtetuese. Seanca e 5 marsit dështoi në mungesë kuorumi, meqë në sallë nuk ishin deputetët e partive opozitare. Kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, kërkoi menjëherë nga Gjykata Kushtetuese të pezullohen afatet kushtetuese në mënyrë që presidenti të zgjidhet brenda 60 ditësh. Kryeministri Kurti në një konferencë për medie e ka kundërshtuar shpërndarjen e Kuvendit, duke theksuar se s'mund të flitet për zgjedhje të reja, meqë duhet të flasë Gjykata Kushtetuese për lëndët që janë deponuar

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 6 MARS** - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka nxjerrë dekret të premtën për shpërndarjen e legjislaturës së dhjetë të Kuvendit meqë, sipas saj, përfaqësuesit e vendit "vendosën ta çojnë vendin në zgjedhje". "Nëpërmjet këtij dekreti po kryej detyrimin kushtetues i cili është i përcaktuar qartë... Është fatkeqësi e madhe që ata [deputetët] nuk zgjedhën interesin e Kosovës", ka thënë Osmani gjatë një konference për medie.

Lëvizja Vetëvendosje (LV), parti në pushtet, ka theksuar se shpërndarja e Kuvendit paraqet akt të paprecedent që bie ndesh me rendin dhe rastin e ka çuar në Gjykatën Kushtetuese.

Më 5 mars ishte afati i fundit kur Kosova do të duhej ta zgjidhte presidentin, 30 ditë para skadimit të mandatit të Osmanit më 4 prill.

Seanca u ndërpre në mungesë të kuorumit, pasi në sallë mungoi opozita.

Në garë ishin Glauk Konjufca dhe Fatmire Kollçaku-Mullhaxha, të dy nga partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje. Si pasojë, kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, i kërkoi Gjykatës Kushtetuese t'i pezullojë përkohësisht afatet kushtetuese për zgjedhjen e presidentit të ri. "Sapo i jemi drejtuar Gjykatës Kushtetuese lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së procedurës për zgjedhjen e presidentit të Republikës së Kosovës. Po përmes kësaj kërkesë kemi kërkuar që Gjykata Kushtetuese të vendosë masë të përkohshme për pezullimin e afatit kushtetues që lidhet me procedurën e zgjedhjes së presidentit, deri në publikimin e aktgjykimit. Lidhur me këtë e kam njoftuar edhe Presidenten, Vjosa Osmani-Sadriu", ka thënë kryeparlamentarja Haxhiu.

Megjithatë, sipas presidentes Osmani, përpjekjet e dështuara të një nate më parë për ta zgjedhur presidentin në Kuvend nuk ishin as rastësore, as të pamenduara, ndonëse deputetët i patën 23 ditë për ta finalizuar procesin prej konstituimit të institucionit. "Përkundrazi, shumë mirë të kalkuluara dhe ideuara, për fat të keq", ka shtuar Osmani. Ajo ka thënë se do t'i shpallë zgjedhjet e reja pas konsultimeve me krerët e



partive politike. "Qytetarët nuk kanë dashur zgjedhje, këtë situatë e ka krijuar dështimi i Kuvendit për ta kryer detyrën kushtetuese. Askush nuk do të duhej të dëshironte një cikël tjetër politik, sidomos në këtë çast kur vendi ka nevojë për stabilitet. Por, këtu e sollën vendin njerëz të papërgjegjshëm, me qëllime të rrezikshme", ka thënë Osmani. Sipas saj, zvarritjet do të krijojnë situata të tjera edhe më të rrezikshme: "Pa qartësi kushtetuese, një proces i zvarritur pa fund, siç e kemi parë edhe më 2025, dhe një shtet që fillon ta relativizojë edhe vetë Kushtetutën e tij".

## Kurti kundërshton shpërndarjen e Kuvendit

Kryeministri Albin Kurti ka mbajtur të premtën një konferencë për medie në lidhje me këto zhvillime. Ai ka thënë se, sipas Kushtetutës, Kuvendi nuk është dashur të shpërndahej tani. Ai e citoi nenin 86 të Kushtetutës që thotë se Kuvendi shpërndahet nëse asnjëri kandidat nuk i mbërrin 61 vota në raundin e tretë. "Tash ndodhemi në një situatë ku s'mund të flasim për zgjedhje të reja pa folur Gjykata Kushtetuese meqë kemi mospajtime dhe kërkesë para këtyre. Ata kanë një materie. Deputetët s'i mbushën as katër javë të detyrës së tyre dhe sot në mëngjes u njoftuam nga mediet se u shpërnda Kuvendi. Neni 86 thotë se Kuvendi shpërndahet nëse në raundin e tretë s'i ka marrë 61 vota. Ne s'kemi mbërrirë atje, s'u konsumua as raundi i parë e lërë më raundi i tretë", ka thënë Kurti në konferencën për medie, duke shtuar se: "Ne nuk

kemi mbërritur ende atje. Dy kandidatë ishin mbrëmë, Glauk Konjufca dhe Fatmire Mullhaxha-Kollçaku, mirëpo nuk u konsumua as raundi i parë lërë më i tretë", tha Kurti. Sipas tij, shpërndarja e Kuvendit do të bëhej vetëm po të dështonte raundi i tretë. Ai ka theksuar se afati 60 ditor për ta zgjedhur presidentin ka nisur mbrëmë dhe, sipas tij, afati 30-ditor që presidenti të zgjidhet pa i mbarur mandati presidentit aktual, flet për nisje të procesit, jo për mbyllje të tij. "I kemi 60 ditë kohë të bëjmë zgjedhje e të mos kemi zgjedhje", është shprehur Kurti.

Ai ka thënë se shpërndarja e Kuvendit ka pamundësuar mbajtjen e një seance të planifikuar për pasditen e së premtës, në të cilën pritej të ratifikoheshin disa marrëveshje ndërkombëtare. Sipas tij, seanca ishte paraparë të mbahej në orën 14:00 dhe kishte për qëllim miratimin e projekteve që lidhen me zhvillimin ekonomik dhe energjetik të vendit.

Kurti ka thënë se ndër marrëveshjet që pritej të shqyrtoheshin ishte një me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) në vlerë prej 50 milionë eurosh për eficiencë të energjisë, një marrëveshje me të njëjtin institucion në vlerë prej 25 milionë eurosh, një marrëveshje me Bankën Evropiane për Investime (BEI) në vlerë prej 33 milionë eurosh për rritjen e kapaciteteve energjetike dhe një marrëveshje me Fondin Saudit për Zhvillim për financimin e projektit të shtrimit të rrugës Prishtinë - Mitrovicë e Jugut. "Pra, bëhej fjalë për marrëveshje ndërkombëtare në vlerë rreth 121 milionë euro, të

dedikuara për projekte të rëndësishme jetike për qytetarët tanë. Me shpërndarjen e Kuvendit pamundësohet realizimi i këtyre projekteve dhe përfitimi i 121 milionë eurove për qytetarët e Kosovës", ka thënë ai.

Kurti ka kritikuar dy partitë kryesore opozitare, PDK dhe LDK, për mungesë të bashkëpunimit të mirëfilltë për një marrëveshje për president. Ai ka thënë se nuk u morën vesh me PDK-në pasi ai tha se nuk ka pranuar të bëjë marrëveshje "blanko" siç kërkonte PDK. "Nuk mund të bëj marrëveshje pa u ditur emri. Kur s'më dhanë emra, thashë hajt të provoj unë t'ua jap një emër", ka deklaruar Kurti teksa përshkruante negociatat me opozitën. Ai ka thënë se nuk u pranua propozimi i tij për emrin e Andin Hotit dhe nuk pranuan më as të takohen. Kurse për LDK-në ka pohuar se i ka thënë se mund të japë veç gjysmën e nënshkrimeve për njërin kandidat.

## Osmani takon liderët e partive për datën e zgjedhjeve të reja

Presidentja Vjosa Osmani pas shpalljes së dekretit për shpërndarjen e Kuvendit ka takuar liderët e partive politike, PDK-së, LDK-së dhe AAK-së, për t'i marrë mendimet për datën e zgjedhjeve të reja. Këtë takim e kanë bojkotuar Lëvizja Vetëvendosje dhe partitë e pakicave minoritare.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka thënë pas takimit me presidenten Osmani, partia e tij ka qenë konstruktive që

Kosova të ketë president të ri, mirëpo situata është si është. "Shpreh keqardhje që kemi ardhur deri në këtë moment. Nuk ka pasur asnjë arsye. Ka pasur më shumë sesa një alternativë. Përgjegjësia kryesore natyrisht se është mbi partinë fituese, partinë më të madhe, sepse ajo ka mundur t'i japë vendit president".

I pyetur nëse partia e tij është e gatshme për zgjedhje, Hamza ka thënë se zgjedhjet janë të panevojshme, të lodhshme për qytetarët e Kosovës, dhe të kushtueshme, mirëpo asnjë parti politike nuk ka mundur t'i japë vendit president, përveç partisë fituese, Lëvizjes Vetëvendosje.

"Lëvizja Vetëvendosje me cilëndo prej partive politike ka mundur t'i japë vendit president. Megjithatë, meqë kemi mbërritur këtu, dhe tashmë është e qartë, ne po flasim për datën kur do të jenë zgjedhjet, meqë ato janë të pashmangshme, PDK-ja i ka strukturat, e ka organizimin, i ka të gjitha", ka thënë ai.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka thënë se partia e tij është e gatshme për zgjedhje të parakohshme kurdo që presidentja Osmani vlerëson se duhet të mbahen ato. Ai tha se në takim pati "diskutime zyrtare për datën e zgjedhjeve". "Kurdo që presidentja vlerëson për afatin kushtetues të rregullt brenda parashikimeve kushtetuese", ka thënë ai, pas takimit konsultativ me Osmanin e përfaqësuesit e subjekteve të tjera.

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, e ka quajtur fyerje për Kosovën e institucionet mospjesëmarrjen e Lëvizjes Vetëvendosje në takimin konsultativ për caktimin e datës së zgjedhjeve. Pas takimit me Osmanin, Haradinaj tha se mungesa e kryeministrit Albin Kurti dhe e përfaqësuesve të partnerëve të tij në qeveri "nuk është në rregull". "Një shije e keqe ishte mospjesëmarrja e Vetëvendosjes me partnerët e tyre qeverisës. Edhe Lista Serbe mungoi në takim. Mospjesëmarrja e tyre sot, qoftë edhe me mendime të kundërta për t'i ballafaquar, për t'i paraqitur në këtë takim, që është më i larti i mundshëm i partive politike parlamentare me presidenten e vendit, për një temë kaq të ndjeshme, është një lloj fyerje për vendin, për Kosovën, për institucionet", shtoi ai.



# PREKAZI, SIMBOL I SAKRIFICËS, UNITETIT DHE VENDOSMËRISË PËR LIRI

5, 6 dhe 7 marsi i vitit 1998 na përkujton qëndresën heroike dhe flijimin e familjes Jashari, një ngjarje që shënoi kthesë historike në rrugëtimin e popullit të Kosovës drejt lirisë dhe pavarësisë. Prekazi mbetet simbol i sakrificës, unitetit dhe vendosmërisë për liri

dha Kosovës gjithçka. Sakrifica e tyre do të mbetet udhërrëfyese ynë në çdo hap që bëjmë për shtetin dhe të ardhmen tonë. Mirënjohje të thellë për pritjen e ngrohtë nga Baca Rifat, simbol i qëndresës dhe i dinjitetit të kësaj familjeje legjendare. Nga Prekazi buron një mesazh që nuk shuhet kurrë: Liria nuk është dhuratë, por amanet. Ky amanet do të jetojë përjetë në zemrat e shqiptarëve”, ka thënë Osmani pas kësaj vizite. Me këtë rast, kryeministri Albin Kurti tha se familjes Jashari ne ia kemi borxh të përjetshëm e të pashlyeshëm angazhimin e përditshëm, që ta ruajmë e ta mbrojmë shtetin dhe të drejtat e liritë e qytetarëve pa dallim. “Tre breza të Jasharëve gjatë atyre

tri ditëve u flijuan për çlirimin e vendit, për lirinë e popullit, për republikën dhe për bashkimin tonë. Andaj, familjes Jashari ne ia kemi borxh të përjetshëm e të pashlyeshëm angazhimin e përditshëm, që ta ruajmë e ta mbrojmë shtetin dhe të drejtat e liritë e qytetarëve pa dallim. Sot Kosova ka ushtrinë e saj, e cila natyrisht që është amanet i kryekomandantit Adem Jashari, i cili bashkë me vëllanë, Hamzën, para se të binin heroikisht në luftë të pabarabartë me forcat armike, për 7 vjet kodrave e maleve të Drenicës e të Kosovës e të Shqipërisë qëndruan e vepruan e organizuan ilegalisht atë që më pastaj bëhet kryengritje gjithëpopullore, bartëse e së

cilës ishte Ushtria e lavdishme Çlirimtare e Kosovës. Andaj, këtë ushtri që po e avancojmë edhe për nga aftësitë edhe për nga madhësia, e shohim gjithashtu edhe si një përmbushje të idealit, të atyre luftëtarëve të orëve të para, të cilët teksa ëndërronin për çlirimin e vendit tonë, njëkohësisht punonin për ushtrinë e popullit tonë”, ka thënë Kurti.

Pas homazheve, kryeministri Kurti, nënkryetari Gola dhe pjesëtarë të tjerë të kabinetit qeveritar vizituan familjen Jashari, ku u mirëpritën nga Rifat Jashari.

Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 28-vjetorit të “Epopesë së UÇK-së”, oficerë të lartë të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së

**EPOKA  
ERE****Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 6 MARS** - Në shënim të 28-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në ditën e dytë të aktiviteteve shtetërore, presidentja Vjosa Osmani, kryeministri Albin Kurti, anëtarë të kabinetit qeveritar, liderë të opozitës, kanë bërë homazhe dhe vendosur

kurora me lule në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

Presidentja Vjosa Osmani ka thënë se në Kompleksin Memorial në Prekaz çdo hap është histori, çdo gur është sakrificë. “Në kuadër të Epopesë së UÇK-së u përkulëm me nderim para altarit të lirisë, para komandantit legjendar Adem Jashari dhe para familjes që i



Mbrojtjes kanë bërë homazhe në kompleksin memorial në Prekaz në nderim të sakrificës së komandantit legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë të rënëve për liri. “5, 6 e 7 marsi i vitit 1998 na përkujton qëndresën heroike dhe flijimin e familjes Jashari, një ngjarje që shënoi kthesë historike në rrugëtimin e popullit të Kosovës drejt lirisë dhe pavarësisë. Prekazi mbetet simbol i sakrificës, unitetit dhe vendosmërisë për liri”, ka njoftuar FSK-ja.

### Hamza pritët nga Rifat Jashari në Prekaz: Sakrifika e familjes Jashari, amanet për ta forcuar Kosovën

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, ka bërë homazhe në Prekaz në nderim të komandantit legjendar Adem Jashari, Hamzë Jasharit, Shaban Jasharit dhe të gjithë të rënëve të familjes heroike Jashari.

Përmes një postimi publik, Hamza tha se Prekazi mbetet vend i shenjtë i sakrificës dhe simbol i qëndresës për lirinë e Kosovës. “Sot në Prekaz, në vendin e shenjtë të sakrificës, nderuam komandantin legjendar Adem Jashari, Hamzën, bacën Shaban dhe të gjithë të rënët e familjes heroike Jashari”, ka shkruar Hamza.

Ai bëri me dije se pas homazheve vizitoi edhe Rifat Jasharin në shtëpinë e familjes Jashari, të cilën e cilësoi si “kala të lirisë”, ku çdo rrëfim dhe çdo kujtim dëshmon për sakrificën e jashtëzakonshme për atdheun.

Hamza theksoi se në qëndrimin dhe fjalët e Rifat Jasharit ndihet ende pesha e historisë dhe madhështia e një familjeje që e ktheu qëndresën në betim për liri. Sipas tij, sakrifika e familjes Jashari mbetet amanet i përhershëm për të gjithë qytetarët që ta ruajnë dhe ta forcojnë Kosovën për çdo brez. “Lavdi e përjetshme komandantit

Adem Jashari dhe gjithë të rënëve të familjes Jashari!”, ka përfunduar Hamza.

### Abdixhiku: Thirrja e Adem Jasharit u bë motiv i djemve e vajzave të UÇK-së

Edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka bërë homazhe në Prekaz në nderim të komandantit legjendar Adem Jashari dhe të gjithë të rënëve të familjes heroike Jashari. “Në këtë shkrim historie, të mos harrojmë, se Ademi, si i pari, nuk ishte vetëm figurë ushtarë. Para se të ishte komandant, ai ishte bir, ishte vëlla, ishte bashkëshort, dhe ishte prind. Ishte njeri i një shtëpie ku jeta vazhdonte si në çdo familje tjetër: me fëmijë, me zëra dhe me shpresë për të ardhmen. Dhe ndoshta pikërisht këtu qëndron madhështia e tij. Diçka që duhet t’ua mësojmë secilës brezni, përfshirë edhe simes. Sepse sakrifika nuk ishte vendim i një njeriu që nuk kishte çfarë të humbiste. Ishte vendim i një njeriu që i kishte gjithçka që një njeri mund të dojë në jetë: familjen, fëmijët dhe jetën”, ka thënë Abdixhiku, duke shtuar se ai vendosi t’i japë të gjitha për ne. “Edhe atë, duke kënduar! Tani kënga, tek shqiptarët lind në momentet më të rënda dhe në momentet më të mëdha. Ajo është mënyra se si një popull i thotë botës se nuk është thyer. Se shpirti i tij është i lirë. Në këngë shqiptarët kanë ruajtur kujtesën e tyre, dhimbjen e tyre, por edhe krenarinë dhe shpresën për të nesërmen. Prandaj kur një shqiptar këndon në momentin e fundit, ai nuk i këndon fundit të tij. Ai i këndon jetës që vazhdon, brezave që do të vijnë dhe lirisë që ende nuk është arritur, por që tashmë është destinim historik”, ka thënë lideri i LDK-së.

Sipas tij, thirrja e Adem Jasharit u dëgjua në gjithë Kosovën. “Ajo u bë motiv i djemve e vajzave të Ushtrisë



Çlirimtare të Kosovës, që në rreshtimin më të madh historik të vendit, u sakrifikuan në vet themelin e shtetit tonë të ri. Komandanti i rënë i tyre, kishte lënë ndjekës që do t’i ndërtonin historitë më të bukura të vendit tonë”, ka thënë Abdixhiku.

premtën. Ai ka thënë se Epopeja e UÇK-së na kujton përpjekjet për liri ndër shekuj, bashkëlufëtarët e rënë dhe na rikujton se edhe ëndrrat më të mëdha bëhen realitet kur je i vendosur dhe në të drejtën e Zotit. “Në Prekazin e komandantit Legjendar Adem

përjetësisht në kujtesën e kombit si një rast unik i flijimit për lirinë e atdheut”, ka thënë Haradinaj.

### Limaj: Prekazi mbetet themeli i shtetit tonë

Edhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, bashkë bashkëpunëtorë, ka shkruar në Prekaz në përvjetorin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për të përkujtuar me nderim të thellë dhe krenari sakrificën sublime të familjes Jashari. Ai ka thënë se Prekazi mbetet themeli i shtetit tonë dhe simbol i qëndresës sonë kombëtare, aty u vulos rruga jonë drejt lirisë dhe pavarësisë, me gjakun dhe trimërinë e bijve më të mirë të këtij vendi. “Heroizmi i komandantit legjendar Adem Jashari dhe i familjes së tij është dëshmi e pathyeshmërisë së popullit tonë. Sakrifika e tyre na obligon çdo ditë që të punojmë me përkushtim për shtetin tonë dhe të mbrojmë e çojmë përpara amanetin e tyre të shenjtë. Lavdi e përjetshme jetës dhe veprës së komandantit legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të Kombit!”, ka shkruar Limaj në “Facebook”.



### Haradinaj: Në Prekazin e komandantit legjendar Adem Jashari përulemi para sakrificës më sublimë për liri

Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka qëndruar në Prekaz të

Jashari përulemi para sakrificës më sublime për liri dhe përkujtojmë qëndresën heroike që u bë themel i shtetit tonë. Familja heroike Jashari, në krye me komandantin legjendar Adem Jashari, nuk u përkul para shtypjes dhe okupimit. Qëndresa e tyre përmbysi shekujt e robërisë dhe mbeti



## FSK-ja DREJT PËRFSHIRJES NË MISION NDËRKOMBËTAR NË GAZA, ZHVILLOHET TAKIM KOORDINUES ME KOMANDËN AMERIKANE

EPOKA E RE  
Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 MARS - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneraljtënant Bashkim Jashari, ka realizuar videokonferencë me komandantin e forcës ndërkombëtare stabilizuese (International Stabilization Force), gjeneralmajor Jasper Jeffers III nga ushtria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për t'i

bërë koordinimet e nevojshme për dislokimin e FSK-së në rripin e Gazës.

Me këtë rast gjeneral Jashari falënderoi gjeneralin Jeffers dhe përmes tij ushtrinë e ShBA-së për ftesën drejtuar FSK-së për të marrë pjesë në këtë operacion ndërkombëtar në rripin e Gazës. Gjithashtu, komandanti i FSK-së konfirmoi gatishmërinë e FSK-së për pjesëmarrje në këtë operacion ndërkombëtar me një kontingjent, duke theksuar

që FSK-ja është ushtri profesionale, e trajnuar me standarde të NATO-s dhe e gatshme të eksportojë siguri kurdo që një gjë e tillë kërkohet nga ushtritë e shteteve partnere, në këtë rast të ShBA-së.

Në fund të takimit, gjenerali Jeffers III falënderoi gjeneral Jasharin për gatishmërinë e FSK-së për të ofruar siguri në lindjen e mesme, duke qenë partner serioz dhe promovuese e paqes dhe stabilitetit në botë.



## APELI ANULON VENDIMIN E THEMELORES QË KISHTE LIRUAR TË DYSHUARIT E KAPUR ME RRETH 1 MILION EURO NË KUFİ

PRISHTINË, 6 MARS - Gjykata e Apelit e Kosovës ka anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, i cili kishte refuzuar kërkesën e Prokurorisë Speciale për caktimin e masës së paraburgimit ndaj tre të pandehurve për veprën penale të shpëlarjes së parave.

Në njoftimin e bërë publik të premten, Apeli bëri me dije se e ka aprovuar të bazuar ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe, sipas detyrës zyrtare, ka anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë -



Departamenti Special, duke e kthyer çështjen në rivendosje. Gjykata Themelore në Prishtinë kishte vendosur më 27 shkurt 2026 që ta refuzojë kërkesën e Prokurorisë Speciale për paraburgim ndaj të pandehurve me inicialet E. A., A. K. dhe A. L., të dyshuar për veprën penale

“Shpëlarja e parave” sipas nenit 302 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në lidhje me dispozitat përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit. Me atë vendim, gjykata e shkallës së parë kishte urdhëruar që të pandehurit të lirohen menjëherë për t'u mbrojtur në liri nga data 27 shkurt 2026.

Megjithatë, Kolegji i Gjykatës së Apelit ka konstatuar se aktvendimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të lidhura me

zbatimin e gabuar të dispozitave materiale.

Sipas Apelit, gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme se si ka arritur në përfundimin se nuk ekziston dyshim i bazuar për kryerjen e veprës penale nga të pandehurit. “Në rastin e refuzimit të kërkesës së Prokurorisë Speciale për caktimin e paraburgimit, gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me mosekzistimin e dyshimit të bazuar”, thuhet në arsyetimin e Apelit.

Po ashtu, sipas kolegjit të kësaj

gjykate, arsyetimi i aktvendimit të shkallës së parë rezultoi të jetë i përgjithësuar, i paqartë dhe në disa pjesë edhe kontradiktor.

Apeli ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë një vlerësim të plotë të materialeve që gjenden në shkresat e lëndës në raport me elementet e veprës penale për të cilën dyshohen të pandehurit.

Për këto arsye, Gjykata e Apelit ka vendosur që aktvendimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Special.

## ARTA GASHI - AHMETAJ SHPALLET MËSUESJA MË E MIRË E VITIT

EPOKA E RE  
Qendresa RAMA

PRISHTINË, 6 MARS - Ministria e Arsimit dhe Shkencës organizoi ceremoninë tradicionale me rastin e 7 Marsit - Ditës së Mësuesit, me ç'rast ndau mirënjohje për mësime të dalluar nga e gjithë Kosova si dhe dha çmimin kryesor “Shaban Jashari” për mësuesen më të mirë të vitit.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, zëvendësministri i parë i Arsimit dhe Shkencës, Përparim Kryeziu, theksoi rëndësinë e rolit

të mësuesve në edukimin dhe formimin e brezave të rinj, duke vlerësuar kontributin e tyre në zhvillimin e shoqërisë. “Mësuesit janë edhe autoriteti i parë dhe për një kohë të gjatë i vetëm për fëmijët, jashtë familjes. Përveçse burim dije e kompetence për fëmijët tanë, ata janë busull vlerore për ta tekta rriten e bëhen brezi i ri qytetar i Republikës”, u shpreh ai.

Kryeziu shtoi se krahas falënderimit që shprehim sot për mësime të dalluar, ata meritojnë edhe respektin e përditshëm, e përkrahurim për ditën e tyre, u



duhet edhe mbështetja për punën që bëjnë çdo ditë. Teksa shënojmë Epopenë e UÇK-së dhe nderojmë qëndresën heroike dhe sakrificën e familjes

Jashari, zëvendësministri Kryeziu përmendi figurën e mësuesit Shaban Jashari, emrin e të cilit mban edhe çmimi kryesor që u nda sot, i cili përfaqëson shembullin se si roli i mësime të dalluar ka qenë më i madh sesa vetëm dhënia e dijes, duke qenë edhe edukim ndër breza për dashurinë ndaj vendit, gjuhës dhe kulturës.

Zëvendësministri Kryeziu përgëzoi mësuesit dhe mësueset e përzgjedhur sivjet si më të dalluarit, duke ua uruar të gjithë mësime të dalluarit 7 Marsin, ndërsa ndau çmimin kryesor

“Shaban Jashari” për mësuesen më të mirë të vitit, Arta Gashi - Ahmetaj.

Mësuesja Arta Gashi - Ahmetaj, duke pranuar çmimin, theksoi se këtë vlerësim e pranon me mirënjohje dhe ia dedikon me dashuri nënës së ndjerë, e cila ka qenë frymëzimi dhe mbështetja në rrugëtimin e saj në arsim.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës uron të gjithë mësime të dalluarit 7 Marsin - Ditën e Mësuesit, duke shprehur mirënjohje për punën dhe përkushtimin e tyre të përditshëm në edukimin dhe formimin e gjeneratave të reja.

## Fuqizohet bashkëpunimi ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Shërbimit Sekret Amerikan

PRISHTINË, 6 MARS - Zëvendës drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Fehmi Hoti, ka pritur në një takim zyrtar një delegacion të përbërë nga përfaqësues të Shërbimit Sekret të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Takimi u zhvillua në frymën e partneritetit dhe besimit të

ndërsjellë ndërmjet institucioneve. Gjatë takimit u diskutua për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit profesional në fushën e sigurisë, shkëmbimin e përvojave dhe avancimin e kapaciteteve institucionale. U theksua edhe mbështetja e vazhdueshme që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë dhënë për Policinë e

Kosovës ndër vite, duke kontribuar në ngritjen e standardeve profesionale dhe forcimin e institucioneve të sigurisë. Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar për ta vazhduar dhe zgjeruar partneritetin strategjik me institucionet amerikane në shërbim të sigurisë dhe sundimit të ligjit.



## KGJK-ja i propozon presidentes 28 gjyqtarë për riemërim me mandat të përhershëm

PRISHTINË, 6 MARS - Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), pas shqyrtimit të raportit të paraqitur nga kryetarja e

Komisionit për Vlerësimin e Performancës, ka miratuar propozimin drejtuar presidentes së Republikës së

Kosovës për riemërimin e 28 gjyqtarëve me mandat të përhershëm. Ky propozim është bazuar në procesin e

vlerësimit të performancës, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin përkatës.



## DHOMA E TREGTISË KUNDËRSHTON FAZËN E DYTË TË LIBERALIZIMIT TË TREGUT TË ENERGJISË

PRISHTINË, 6 MARS - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Kosovës ka shprehur kundërshtimin ndaj planit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRë) për ta nisur fazën e dytë të liberalizimit të tregut të energjisë e cila parashikohet të fillojë nga muaji prill. Në një komunikatë, Dhoma thekson se "forma e zgjedhur për liberalizim është e gabuar, pa asnjë analizë paraprake, me mungesë mekanizmash kontrollues dhe me një mori shkeljesh të



vërtetuara nga Gjykata Supreme e Kosovës".

Sipas Dhomës, kompanitë që dolën vitin e kaluar në tregun e hapur të energjisë u përballën me fatura trefish më të larta dhe reduktime të ashpra, duke pësuar dëme të mëdha financiare dhe operative, që rrezikuan qëndrueshmërinë e bizneseve dhe vendet e punës. "Agjencia e Statistikave e Kosovës i vërtetoi paralajmërimet tona për rritje të çmimeve dhe kostos së prod-

imit, që ndikuan në rritjen e importit", thuhet në njoftim.

Dhoma i bën thirrje Kuvendit të Kosovës dhe komisioneve përkatëse të ndërmarrin masa të shpejta për t'i vënë para përgjegjësisë aktorët e energjisë, për të shmangur pasoja të mëtejshme për bizneset dhe ekonominë.

Në përfundim, Dhoma thekson se situata kërkon veprime urgjente para se të jetë vonë për kompanitë dhe tregun e energjisë në Kosovë.

## RRITEN ÇMIMET E PRONAVE TË BANIMIT

PRISHTINË, 6 MARS - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Pronave të Banimit (IÇPB) për tremujorin e katërt (TM4) 2025, me vitin bazë 2018 = 100.

Indeksi i Çmimeve të Pronave të Banimit (IÇPB) në Kosovë u rrit 5,5 % në TM4 2025 krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2024. Po ashtu, krahasuar me tremujorin e tretë (TM3) 2025 çmimet e pronave të

banimit shënuan rritje prej 5,5 %. Indeksi i Çmimeve të Pronave të Banimit u rrit me një mesatare prej 4,9 % në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024.

Në rajonin e Prishtinës çmimet e pronave të banimit u rritën 4,9 % në TM4 2025 krahasuar me TM4 2024. Për rajonet e tjera të vendit, çmimet e pronave të banimit u rritën 4,3 % në TM4 2025 krahasuar me TM4 2024.



## KRYETARI I OEK-UT VIZITON 'ABI PROGRES' NË KRUSHË TË VOGËL, VLERËSON ARRITJET E KËSAJ KOMPANIE

PRISHTINË, 6 MARS - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, ka zhvilluar një takim me pronarin e kompanisë "ABI Progres", Irfan Fusha, në ambientet e fabrikës në Krushë të Vogël. Rafuna shprehu kënaqësinë për punën dhe arritjet e

kompanisë, duke theksuar gamën e gjerë të produkteve të "ABI Progres", të cilat eksportohen në rajon dhe Evropë dhe cilësinë e lartë që i bën ato një "ambasador" të Kosovës në tregjet ndërkombëtare.

Ai falënderoi kompaninë për

kontributin dhe mbështetjen ndaj OEK-ut, duke vlerësuar arritjet e "ABI Progres" si një nga kompanitë më të suksesshme në vend, me shumë shpërblime për eksporte, kontribut të lartë fiskal dhe si një ndër punëdhënësit më të mëdhenj.

## Arton Konushevci emërohet zëvendësministër i parë i Administrimit të Pushtetit Lokal

PRISHTINË, 6 MARS - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka

emëruar Arton Konushevci në pozitën e zëvendësministrit të parë në Ministrinë e

Administrimit të Pushtetit Lokal. Kryeministri Kurti e uroi Arton Konushevcin për

detyrën e re dhe i dëshiroi suksese në përmbushjen e përgjegjësisë të reja.



# PSE SHBA GODITI IRANIN DHE VENEZUELËN: LOJA E MADHE E NAFTËS PËR TË DOBËSUAR KINËN



Goditjet ndaj Iranit janë pjesë nga loja e madhe e naftës e Shteteve të Bashkuara, që shtrihet përtej Lindjes së Mesme dhe synon të ushtrojë presion mbi Kinën, vendin që Uashingtoni e sheh si rivalin e tij kryesor global. Kështu u shprehën disa analistë për Newsweek.

Këto goditje përbëjnë sulmin e dytë amerikan brenda më pak se tre muajsh kundër një aleati të pasur me naftë të Kinës, pasi më herët këtë vit SHBA ndërmori një operacion ushtarak edhe kundër Venezuelës, duke rrëzuar qeverinë e atjeshme.

Si Venezuela ashtu edhe Irani kanë qenë miq të ngushtë dhe aleatë strategjikë të Kinës, e cila blinte naftë prej tyre me kushte shumë të favorshme.

## Loja e madhe e naftës: SHBA po shënjestron furnizimin me naftë të Kinës

Shtetet e Bashkuara e shohin Kinën si rivalin e tyre kryesor në skenën globale. Kapaciteti i madh industrial i Kinës dhe ndërtimi i shpejtë i flotës së saj detare e vendosin Pekinin në pozicion për të sfiduar dominimin ushtarak amerikan në Paqësor, ashtu sikurse edhe ndikimin e tij global.

Ndërkohë, ushtria kineze ka zhvilluar gjithnjë e më shumë

stërvitje agresive ushtarake rreth Tajvanit, duke rritur frikën për një pushtim të mundshëm.

Në Iran, ashtu si edhe në Venezuelë në janar, edhe pse kishte shumë faktorë në lojë, analistët thonë se bëhej fjalë për diçka më shumë sesa politika lokale apo rajonale.

“Objektivi është të mbyllet burimi kryesor i naftës së lirë për Kinën”, tha Madi Kapparov, ekonomist dhe drejtues kërkimesh në Centre for Information Defence and Strategies, me zyrë në Londër. Sipas Kapparovit, ndërprerja e furnizimeve me naftë për Kinën përbën një kërcënim të veçantë për ushtrinë kineze, e cila ka nevojë për një furnizim të qëndrueshëm me benzinë dhe naftë për të operuar.

## Pse Irani dhe Venezuela janë kaq të rëndësishëm për Pekinin

Kina ka investuar shumë në centrale të reja me qymyr dhe në energji të rinovueshme, por siç thekson ai, “një ushtri nuk mund të funksionojë me qymyr apo energji të rinovueshme”.

Për vite me radhë, Pekini kishte arritur të ulte çmimin e naftës që blinte nga Irani, pasi vendi kishte pak blerës për shkak të sanksioneve ndërkombëtare afatgjata mbi programin e tij bërthamor.

Sipas firmës analitike Kpler, Kina bleu më shumë se 80 për qind të naftës së eksportuar nga Irani në vitin 2025.

Shifrat për përqindjen e naftës që Kina importon nga Irani ndryshojnë nga 0 deri në 18 për qind, pasi të dhënat doganore kineze ndaluan raportimin e dërgesave nga Irani në vitin 2022, tha Kapparov.

Sipas Reuters, rreth 13 për qind e naftës bruto që Kina transporton përmes detit vjen nga Irani. Megjithatë, kjo tregti zhvillohet shpesh në fshehtësi, me transferime nga anije në anije, përfshirë edhe pranë brigjeve të Malajzisë.

## A mund ta zëvendësojë Kina naftën iraniane me atë ruse?

Deri në janar, Venezuela furnizonte rreth 4 për qind të nevojave të Kinës për naftë. Por shpresat në Pekin se humbja e naftës venezueliane do të kompensohej nga importet iraniane tani duket se janë shuar. Kina blen gjithashtu naftë nga Rusia, një tjetër aleat politik, por zëvendësimi i naftës iraniane nuk është aq i thjeshtë, pasi nafta ruse mund të kërkojë procese të ndryshme rafinimi.

Pekini blen naftë edhe nga vende të tjera, por këto furnizime thjesht tregtare mund të rrezikoheshin nëse Kina do të

pushtonte Tajvanin, pasi vendi do të përballej me sanksione ndërkombëtare të ngjashme me ato që iu vendosën Rusisë pas pushtimit të Ukrainës.

## Teoria e dominosë në strategjinë amerikane

Sipas Ross Babbage, drejtor ekzekutiv i Strategic Forum, një konsulencë strategjike me bazë në Australi, dhe bashkëpunëtor në Center for Strategic and Budgetary Assessments në Uashington, zhvillimet në Iran janë pjesë e një strategjie edhe më të madhe.

Me sulmin ndaj Iranit dhe vdekjen e ajatollahut Ali Khamenei, një tjetër lider autoritar jetëgjatë ka rënë, tha Babbage. “Duket se ekzistojnë elementët e një strategjie amerikane, dhe duket se ajo po bën përparim të vërtetë”, u shpreh ai.

“Vendet që kanë qenë bastione autoritare po bien një nga një. Partnerët e Pekinit dhe Moskës po zvogëlohen në numër dhe në peshë strategjike.”

Sipas tij, ajo që po ndodh është një seri hapash nga Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e tyre, veçanërisht Izraeli në rastin e Iranit, për të ndryshuar orientimin pro-autoritar të këtyre shteteve. Qëllimi është që këto vende të ndryshojnë kurs dhe të bëhen të paktën neutrale, në mos pro-perëndimore.


Megjithatë, Babbage paralajmëron se konturet e strategjisë amerikane mbeten ende të paqarta. “Do të isha i pari që do të thosha se provat janë të shpërndara. Disa njerëz në administratën amerikane duket se kanë një vizion mjaft koherent, por në zbatimin praktik ka shumë faktorë të tjerë për t’u marrë parasysh, përfshirë vendimarrjen rreth operacionit aktual në Iran”, tha ai.

## A janë Kina dhe Rusia partnerë të besueshëm?

Në një plan më të gjerë, zhvillimet në Iran dhe në Venezuelë kanë ngritur pikëpyetje jo vetëm për Kinën dhe Rusinë, por edhe për partneritetet e tyre në botën në zhvillim, ku të dyja vendet kanë zgjeruar ndikimin e tyre me shpejtësi në vitet e fundit.

“Ata flasin me terma madhështore për regjimet që i mbështesin dhe që janë partnerët e tyre. Por kur vjen momenti i së vërtetës, çfarë kanë bërë për të mbështetur Venezuelën kundër Shteteve të Bashkuara? Përgjigjja është se në fakt nuk mundën të bëjnë asgjë,” tha Babbage.

“Sipas meje, situata është shumë e ngjashme edhe me Iranin.” Ai parashikon se Kuba mund të jetë vendi i radhës. “Po shohim një mundësi shumë reale që Kuba të rrezohet brenda muajve të ardhshëm.” / newsweek – bota.al



## Broja mund t'i thotë "mirupafshim" Kombëtares shqiptare



**TIRANË, 6 MARS** - Armando Broja me shumë mundësi do t'i thotë "mirupafshim" Kombëtares shqiptare sa i përket "play-off"-it të Botërorit. Gjasat janë të

larta që sulmuesi kuqezi të mungojë përballë Polonisë. Dëmtimi i pësuar me Burnleyn dhe rikuperimi i "ngadaltë" ka barë që Broja të mos ketë asnjë

shans grumbullimi me Shqipërinë. Kështu, Sylvinho do të ketë një "armë" më pak në sulm. Kujtojmë se Kombëtarja shqiptare do të

përballet me Poloninë më 26 mars. Në rast fitoreje, kuqezinjtë do të luajnë me triumfuesin e ndeshjes paralele, Ukrainë - Suedi.

## RIKTHEHET SUPERLIGA E KOSOVËS NË FUTBOLL ME NDESHJE INTERESANTE

**PRISHTINË, 6 MARS** - Vetëm dy ndeshje do të luhen në fundjavë në kuadër të javës së 23-të të Superligës së Kosovës në futboll. Për shkak të ndeshjeve të Kupës së Kosovës që janë zhvilluar në mesjavë, tri duele të kësaj xhiroje do të luhen të hënën e javës që po vjen, ndërsa dy të tjera janë sot (e shtunë) dhe nesër (e diel). Dueli i parë i kësaj jave luhet sot (e shtunë) në Gjilan ndërmjet Dritës dhe Prishtinës

së Re, me fillim nga ora 13:00. Gjilanasit që do të luajnë vetëm për ta mbrojtur titullin e kampionit janë në vendin e dytë, por me pikë të barabarta sa lideri Ballkani, gjithsej 39. Në letër janë favoritë ndaj skuadrës debutuese në Superligë, por që Prishtina e Re, pas rezultateve të mira, është larguar nga fundi i tabelës me 22 pikë, lufton bashkë me katër skuadra të tjera për të mbijetuar. Ndërsa

nesër (e diel) në orën 13:00 Drenica, e cila tashmë e përmbyll renditjen me vetëm 21 pikë dhe pa fitore në pesë ndeshjet e fundit, kthehet në Skenderaj dhe e pret Dukagjinin e mesit të tabelës. Të hënën zhvillohen tri duele shumë interesante nga ora 13:00. Malisheva e pret Prishtinën, Ferizaj është nikoqir i Gjilanit dhe Llapi luan në shtëpi kundër Ballkanit.



## MESSI TAKOHET ME TRUMPIN NË SHTËPINË E BARDHË

Lionel Messi i ka dhuruar presidentit të ShBA-së, Donald Trump, një top të dekoruar gjatë një ceremonie të organizuar në Shtëpinë e Bardhë për nder të Inter Miamit, përkatësisht triumfit të skuadrës në MLS edicionin e kaluar. Inter Miami e kishte mposhtur Vancouverin në dhjetor për titullin e ligës kryesore të ShBA-së në futboll. Superylli argjentinas ishte lojtari më i vlefshëm për të dytin edicion radhazi. "Leo, ti erdhe dhe fitove, dhe kjo është diçka



shumë e vështirë për t'u bërë. Është shumë, shumë e pazakontë dhe sinjerisht ka shumë më tepër presion mbi ty sesa do ta

dinte kushdo, sepse ti prisje të fitoje, por thujse askush nuk fiton", ka thënë Trumpi gjatë pritjes. Messi ka hyrë në ceremoni së bashku me Trumpin. Ai i është bashkuar Inter Miamit në vitin 2023 me bujë të madhe. Argjentinas nuk ka folur gjatë ngjarjes, që është bërë politike herë pas here. Trumpi ka folur për luftën me Iranin, situatën në Venezuelë, për një njoftim të mundshëm për Kubën, madje edhe për tarifën.

Duke iu drejtuar Messit, që eviton fjalimet politike, presidenti Trump është përqendruar kryesisht te sporti. "Mund të kishe shkuar kudo në botë. Mund të kishe zgjedhur çdo ekip në botë dhe zgjedhe Miamin. Nuk të fajësoj. Moti është jashtëzakonisht i mirë. A shkon në Doral? A shkon në Doral dhe luan golf?", ka thënë Trumpi, duke iu referuar një fushe golfi që e ka ai. "Dua vetëm të të falënderoj që na solle të gjithëve në këtë udhëtim, sepse je tërheqës dhe i

talentuar. Je person i shkëlqyer", i është drejtuar tutje Trump yllit të futbollit. Inter Miami është ekipi i parë i MLS-së i ftuar në Shtëpinë e Bardhë gjatë dy mandateve të Trumpit në zyrë. Messi është fitues i tetëfishtë i Topit të Artë, ndërsa e ka udhëhequr Argjentinën drejt Kupës së Botës 2022. 38-vjeçari pritet të luajë sërish për Argjentinën këtë verë, kur Botërori organizohet në ShBA, Kanada dhe Meksikë.

## LEBRON JAMESI RISHKROI HISTORINË, THYEN NJË REKORD QË KISHTE QENË I PADISKUTUESHËM PËR 37 VJET



**LOS ANGELES, 6 MARS** - LeBron James ka vendosur një tjetër rekord në ligën më të fortë të basketbollit, NBA, pasi ka tejkaluar Kareem Abdul-Jabbar në vitin 2023, duke u bërë koshshënuesi më i mirë i të gjitha kohëve në NBA. Konkretisht, James i shkëlqyer e ka tejkaluar qendrën legjendare në ndeshjen e fundit të luajtur

në numrin e koshave të shënuar nga fusha në NBA (15 838 pikë). Ai e ka arritur rekordin në çerekun e parë të ndeshjes kundër Denver Nuggets, me një gjuajtje me rikthim nga gjysmë distanca. Abdul-Jabbar ka shënuar 15 837 pikë nga fusha gjatë karrierës së tij 20-vjeçare në NBA dhe shumë menduan se ai rekord që

ka zgjatur 37 vjet nuk do të thyhej kurrë. Më parë James e ka kaluar Abdul-Jabbarin për sa iu përket minutave, përpjekjeve për gjuajtje nga fusha dhe numrit të përgjithshëm të pikëve të shënuara (43 111 deri në këtë ndeshje). Gjatë karrierës së tij 23-vjeçare, James ishte 22 herë pjesë e All-Starit, më pas u

zgjedh në 21 ekipe All-NBA, gjashtë herë në ekipin All-Defensive, ishte koshshënuesi më i mirë në sezonin 2008, katër herë kampion i NBA-së e shumë rekorde të tjera. Këtë sezon ai po luan në një nivel të lartë për LA Lakers, duke shënuar mesatarisht 21.6 pikë, 7 asistime dhe 5.6 kërcime për ndeshje.

## Lëndimi i Ronaldos, më serioz sesa pritej, rrezikon Kupën e Botës

**RIAD, 6 MARS** - Trajneri i Al-Nassrit, Jorge Jesus, ka dhënë një përditësim shqetësues në lidhje me dëmtimin e muskulit të kofshës së pasme të Cristiano Ronaldos. Sulmuesi portugez është lënduar gjatë ndeshjes

kundër Al-Fayha fundjavën e kaluar dhe duket se ky lëndim nuk është edhe aq i lehtë. Është vetë trajneri i klubit saudit, Jesus, i cili ka treguar situatën e dëmtimit të sulmuesit portugez. "Pas analizave pamë se dëmtimi

i pësuar nga Cristiano Ronaldo ishte më serioz nga sa pritej", ka thënë Jesus, duke shtuar se Ronaldo do të udhëtojë për në Spanjë për shërim. "Lëndimi i tij kërkoi trajtim në Madrid me terapistin e tij personal dhe

shpresojmë që ai të kthehet shpejt dhe ta ndihmojë ekipin", ka thënë trajneri i Al Nassrit. Afati i saktë kohor i rikuperimit nuk është zbuluar, gjë që ngre dyshime mbi shanset e tij për të luajtur në Kupën e Botës 2026.



## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Kuzhina Meda” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812293017 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Kuzhina Meda” D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812293017 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Kuzhina Meda” L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 812293017 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Radio X” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811363051 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Radio X” D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811363051 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Radio X” L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 811363051 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrrapa Teatrit, 4 llullat, Rr. Bajram Kelmendi

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

- “HiDubai Kosova” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e Biznesit me nr. Unik Identifikues: 812047513.

- “Central Europe Soulutions” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e Biznesit me nr. Unik Identifikues: 812269167.

- “Priam dev” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së.

- N.T.SH “Creative”, me seli në Gjakovë shpall të pavlefshme numrin e certifikatës së biznesit: 810244997, të lëshuar nga MTI.

- Aferdita Qabrati shpall të pavlefshme dëftesën e klasës I-VIII të lëshuar nga SHFMU “Vëllezërit Frashëri”, Planej.

- Mihill Gjovelekaj shpall të pavlefshme diplomën e QK “11 Marsi”, Prizren.

- Gjatë gjithë muajit mars, të gjitha gratë do të përfitojnë 40% zbritje në regjistrim dhe shërbimet e auto shkollës.

- Kjo iniciativë vjen si një shenjë vlerësimi dhe respekti për gratë, duke u ofruar atyre mundësi më të lehtë për t’u pajisur me patentë shoferi dhe për të fituar pavarësi në komunikacion.

- Për më shumë informata dhe regjistrime, të interesuarat mund të drejtohen pranë Auto Shkollës “Trimi” SH.P.K. gjatë orarit të punës.

Milaim Sh. Hajdari shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike mekanik i radiotelevizionit të shkollës “Gjin Gazulli” Prishtinë.

Kujtim Hakaj shpall të pavlefshme diplomën e sh, profesionale “Dituria” Prizren.

Tahir Neziri shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Kuvendi i Juniku” Junik.

Zejnije Morina shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Xhelal Hajda Toni” Ratkoc Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.





KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSI "MITROVICA" SH.A.



Në bazë të funksioneve dhe kompetencave që parashihen në nenin 21, lidhur me nenin 25 paragrafi 25.2 pika (h) si dhe nenin 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Ligji nr.03/L-087), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-111 dhe Ligjin nr.05/L-009 për NP, Komisioni i Auditimit të KRU "Mitrovica" Sh.A., vendosi të shpall këtë:

### KONKURS PUBLIK

**Titulli i punës:** Zyrtar/e i/e Auditimit të Brendshëm

**Vendi:** Mitrovicë-Suhodoll

**Ndërmarrja:** Kompania Rajonale Ujësjiellësi, Mitrovica, Sh.A.

**I përgjigjet:** Komisionit të Auditimit të Brendshëm të KRU "Mitrovica" Sh. A, Mitrovicë.

**Paga bazë:** 1153.99 euro

**Mandati:** 3 vite- me mundësi vazhdimi

**Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:**

Komisioni i Auditimit dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (k) dhe (l) dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë.

Përveç këtyre kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Diplomë universitare në **ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike** ose fusha të tjera relevante për sektorin që auditohet (kopja e noterizuar ndërsa diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të **nostrifikuara** nga MASHTI);
- **Certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik**, e lëshuar nga Ministria e Financave ose ndonjë institucion relevant vendor/ndërkombëtar në pajtim me kriteret e MF;
- **Certifikatë Kontabilist i Çertifikuar** nga shoqata profesionale të licencuara;
- Së paku **5 vite përvojë pune** - në harmoni me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087;
- Aftësi organizative, menaxhuese të njoh punën me kompjuter excel, word etj.
- Të mos ketë konflikt interesi që do ta pengonte personin në ushtrimin e rregullt, të pavarur dhe objektiv të detyrave të tij ndaj Aksionarit. Personi duhet të jetë me integritet të dëshmuar.

**Funksioni dhe përgjegjësitë kryesore të Zyrtari i Auditimit të Brendshëm të përcaktuara me Statutin e kompanisë:**

Zyrtari i Auditimit të Brendshëm

Nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Komisionit të Auditimit, dhe duke i raportuar ekskluzivisht atij, zyrtari i auditit të brendshëm të Shoqërisë ( "Zyrtari i Auditimit të Brendshëm ") do të jetë përgjegjës për:

- Udhëheqjen, menaxhimin dhe organizimin e brendshëm të zyrës së auditimit, duke zgjedhur stafin e saj;
- Udhëheq dhe drejton të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm; dhe
- Përbush çfarëdo detyre tjetër të përcaktuar nga ana e Komisionit të Auditimit.

**Detyrat dhe përgjegjësit e Zyrtarit/es së Auditimit të Brendshëm janë:**

- Përpilimin e procedurave të auditimit, gjegjësisht planit të Auditimit të Brendshëm, për të gjitha transaksionet e Kompanisë konform objektivave të kontrollit të brendshëm, politikave dhe procedurave të Kompanisë bazuar në legjisllacion të aplikueshëm,

- Shqyrtimin e planit të investimeve dhe financiar të kompanisë, planit vjetor të biznesit dhe buxhetin vjetor,
- Shqyrtimin e pasqyrës vjetore të bilancit dhe deklaratat e fitimeve dhe humbjeve si dhe deklarata financiare që kërkojnë me ligj,
- Vlerësimi objektiv të shfrytëzimit efektiv të burimeve të Kompanisë dhe dhënia e rekomandimeve adekuate për Komisionin e Auditimit dhe Menaxhmentin e Kompanisë,
- Verifikimin e përshtatshmërisë dhe funksionimn e rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin nga Kompania të gjitha ligjeve të aplikueshme në Kosovë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe punëve të saj, dhe t'i sigurojë Komisionit të Auditimit çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme,
- Verifikimin e rregullt të përshtatshmërisë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim që të sigurojnë se librat dhe dokumentacioni i Kompanisë duke përfshirë dokumentacionin financiar, mbahen në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe me ligjin, dhe që projekt-deklaratat vjetore financiare të përgatiten në mënyrë të rregullt,
- Kryen analizë sistematike të proceseve të biznesit dhe kontrolleve të ndërlidhura me to,
- Raporton rregullisht para Komisionit të Auditimit,
- Udhëheq dhe menaxhon organizimin e brendshëm të zyrës së auditimit,
- Udhëheq dhe drejton të gjitha aktivitetet e Auditimit të Brendshëm,
- Mban raporte të mira me Komisionin e Auditimit, Auditorët e jashtëm, Menaxhmentin dhe stafin e Kompanisë,
- Përbush çfarëdo detyre tjetër të përcaktuar nga Komisioni i Auditimit,
- Për punën që kryen i përgjigjet Komisionit të Auditimit të Brendshëm.

**Procedura e aplikimit:**

**Dokumentet e kërkuara**

Kandidatët e interesuar duhet t'i bashkëngjisin këto dokumente:

- Aplikacionin zyrtar të KRU "Mitrovica".
- CV-në (jetë përshkrimi);
- Letër motivimi;
- Kopjen e diplomës universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike ose fusha të tjera relevante për sektorin që auditohet (kopja e noterizuar ndërsa diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHTI);
- **Certifikatën për auditor të brendshëm në sektorin publik**, e lëshuar nga Ministria e Financave ose ndonjë institucion relevant vendor/ndërkombëtar në pajtim me kriteret e MF;
- **Certifikatë Kontabilist i Çertifikuar** nga shoqata profesionale të licencuara;
- Dëshmi mbi përvojën e punës (trustin apo kontratë pune mbi përgjegjësit dhe detyrat e punës ose vërtetim nga punëdhënësi që dëshmon së paku **5 vite përvojë pune** - në harmoni me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087;
- Deklarata nën betim e cila mund të shkarkohet nga uebfaqja e kompanisë;
- Certifikatën nga evidenca penale, jo më të vjetër se 6 muaj, që dëshmon se aplikanti nuk është dënuar me më shumë se 6 muaj burgim me vendim të formës së prerë.
- Kopjen e letërnjoftimit të lëshuar nga Republika e Kosovës.

Aplikacioni dhe Deklarata nën Betim mund të merren në ueb -faqen e Kompanisë në adresën: <https://www.kru-mitrovica.com/konkurset/>.

Aplikacionet dhe dokumentet përcjellëse duhet të dorëzohen të skanuara ose në formatin .pdf në email adresën: [rekrutimi@kru-mitrovica.com](mailto:rekrutimi@kru-mitrovica.com)

Afati për aplikim është **30 ditë** nga dita e publikimit të Konkursit Publik duke filluar nga data: **09.03.2026** deri me datën **07.04.2026** ora 24:00.

**Vërejtje:** Kandidatët me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar dhe jo-adekuat dhe jashtë afatit të konkurrimit, do të refuzohen.

KRU "Mitrovica" Sh.A. Mitrovicë-Suhodoll. L.H.





### KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD "Mitrovica" D.D.

Na osnovu funkcija i ovlašćenja predviđenih članom 21, u vezi sa članom 25 stav 25.2 tačka (h), kao i članom 17 Zakona o javnim preduzećima (Zakon br. 03/L-087), izmenjenog i dopunjenog Zakonom br. 04/L-111 i Zakonom br. 05/L-009 o javnim preduzećima, Komisija za reviziju KRU „Mitrovica“ A.D. donosi odluku da objavi sledeći:

#### JAVNI KONKURS

**Naziv radnog mesta:** Službenik/ca Interne Revizije

**Mesto:** Mitrovica – Suvi Do

**Preduzeće:** Kompanija Regionalni Vodovod „Mitrovica“ A.D.

**Odgovara:** Komisiji za internu reviziju KRU „Mitrovica“ A.D., Mitrovica

**Osnovna plata:** 1.153,99 evra

**Mandat:** 3 godine – sa mogućnošću produženja

#### Uslovi i potrebne kvalifikacije:

Komisija za reviziju želi da obezbedi da svi potencijalni kandidati budu lica sa dokazanim integritetom koja ispunjavaju uslove kvalifikacije prema članu 17.1, ispunjavaju kriterijume nezavisnosti prema članu 17.2, tačke (d), (f), (k) i (l), kao i da poseduju potrebno profesionalno iskustvo i obrazovanje za predmetnu poziciju.

#### Pored ovih opštih uslova, kandidati moraju ispuniti i sledeće posebne uslove:

- Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomije, prava, javne administracije, javnih finansija ili drugih relevantnih oblasti za sektor koji se revidira (notarski overena kopija, dok diplome sa stranih univerziteta moraju biti nostrifikovane od strane MASHTI-ja).
- Sertifikat internog revizora u javnom sektoru, izdat od Ministarstva finansija ili relevantne domaće/međunarodne institucije u skladu sa kriterijumima MF.
- Sertifikat ovlašćenog računovođe izdat od licenciranih profesionalnih udruženja; Najmanje 5 godina radnog iskustva – u skladu sa Zakonom o javnim preduzećima br. 03/L-087.
- Organizacione i menadžerske sposobnosti; poznavanje rada na računaru (Excel, Word itd.).
- Da ne postoji sukob interesa koji bi sprečavao lice u redovnom, nezavisnom i objektivnom obavljanju dužnosti prema Akcionarar. Lice mora imati dokazan integritet.

#### Glavne funkcije i odgovornosti Službenika/ce interne revizije, utvrđene Statutom kompanije:

Službenik/ca interne revizije

Pod rukovodstvom i nadzorom Komisije za reviziju, i izveštavajući isključivo toj Komisiji, službenik/ca interne revizije Društva („Službenik/ca interne revizije“) biće odgovoran/na za:

- Rukovođenje, upravljanje i interno organizovanje kancelarije interne revizije, uključujući izbor njenog osoblja;
- Vođenje i upravljanje svim aktivnostima interne revizije.
- Izvršavanje svih drugih dužnosti koje odredi Komisija za reviziju.

#### Dužnosti i odgovornosti Službenika/ce interne revizije su:

- Izrada procedura revizije, odnosno Plana interne revizije, za sve transakcije Kompanije u skladu sa ciljevima interne kontrole, politikama i procedurama Kompanije zasnovanim na važećem zakonodavstvu;

- Razmatranje investicionog i finansijskog plana Kompanije, godišnjeg poslovnog plana i godišnjeg budžeta;
- Razmatranje godišnjeg bilansa stanja, bilansa uspeha i finansijskih izveštaja koji se zahtevaju zakonom;
- Objektivna procena efikasnog korišćenja resursa Kompanije i davanje adekvatnih preporuka Komisiji za reviziju i Menadžmentu Kompanije;
- Provera usklađenosti i pravilnog funkcionisanja sistema i procedura kojima se obezbeđuje primena svih važećih zakona u Republici Kosovo tokom obavljanja delatnosti Kompanije, kao i dostavljanje Komisiji za reviziju svih zapažanja ili sugestija koje smatra potrebnim;
- Redovna provera usklađenosti i pravilnog funkcionisanja sistema i procedura kojima se obezbeđuje da poslovne knjige i dokumentacija Kompanije, uključujući finansijsku dokumentaciju, budu vođene u skladu sa računovodstvenim standardima i zakonom, kao i da se godišnji finansijski izveštaji pripremaju na pravilan način;
- Sprovođenje sistematske analize poslovnih procesa i kontrola povezanih sa njima;
- Redovno izveštavanje Komisije za reviziju;
- Rukovođenje i upravljanje internom organizacijom kancelarije interne revizije;
- Održavanje dobrih profesionalnih odnosa sa Komisijom za reviziju, spoljnim revizorima, Menadžmentom i osobljem Kompanije;
- Izvršavanje svih drugih dužnosti koje odredi Komisija za reviziju;
- Za svoj rad odgovara Komisiji za Internu Reviziju.

#### Procedura prijavlivanja:

#### Potrebna dokumentacija

Zainteresovani kandidati treba da dostave sledeća dokumenta:

- Zvaničnu prijavu KRU „Mitrovica“;
- Biografiju (CV);
- Motivaciono pismo;
- Kopiju univerzitetske diplome iz oblasti ekonomije, prava, javne administracije, javnih finansija ili drugih relevantnih oblasti za sektor koji se revidira (notarski overena kopija, dok diplome sa stranih univerziteta moraju biti nostrifikovane od strane MASHTI-ja);
- Sertifikat internog revizora u javnom sektoru, izdat od Ministarstva finansija ili relevantne domaće/međunarodne institucije u skladu sa kriterijumima MF;
- Sertifikat ovlašćenog računovođe izdat od licenciranih profesionalnih udruženja;
- Dokaz o radnom iskustvu (trust ili ugovor o radu sa opisom odgovornosti i radnih zadataka, ili potvrda poslodavca kojom se dokazuje najmanje 5 godina radnog iskustva – u skladu sa Zakonom o Javnim Preduzećima br. 03/L-087);
- Izjavu pod zakletvom koja se može preuzeti sa veb-stranice Kompanije;
- Uverenje iz kaznene evidencije, ne starije od 6 meseci, kojim se potvrđuje da kandidat nije osuđivan na kaznu zatvora dužu od šest meseci pravosnažnom sudskom odlukom;
- Kopiju lične karte izdate od Republike Kosovo.

Prijava i Izjava pod zakletvom mogu se preuzeti na veb-stranici Kompanije na adresi: <https://www.kru-mitrovica.com/konkurset/>

Prijave i prateća dokumentacija dostavljaju se skenirane ili u pdf formatu na imejl adresu:

[rekrutimi@kru-mitrovica.com](mailto:rekrutimi@kru-mitrovica.com)

Rok za prijavu je 30 dana od dana objavljivanja Javnog konkursa, počev od 09.03.2026. godine do 07.04.2026. godine do 24:00 časova.

**Napomena:** Kandidati sa nepotpunom, neadekvatnom ili neblagovremeno dostavljenom dokumentacijom neće biti razmatrani.

KRU „Mitrovica“ A.D.  
Mitrovica – Suvi Do



**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

